

*Titulli i Projektit: **INTERVET WB***
Numri i referencës së projektit: EAC-2019-0571
*Kodi i Thirrjes: **INTERVET_Kosovë 3/2022_ST***

Thirrje për pjesëmarrës për Internship në vendet Europiane

UNISER, aplikant dhe koordinator i projektit **Intervet WB**, bashkë me **Prishtina REA** si partner implementues për Kosovë, ofrojnë mundësinë për internship në vendet tjera të BE me qëllimin të:

- **Ofrimit** të mundësive për student nga shkollat profesionale (VET schools) të përfitojnë aftësi profesionale e teknike përmes kurrikulave të nternship-eve, në linjë me trainimet e tyre, pra duke ngritur punësueshmërinë e tyre pas përfundimit të këtyre kurseve të ofruara,
- **Përmirësimin e modernizimit të trainimeve**, duke investuar në metodologji të reja sikurse janë internship-et në mobilitet jashtë vendi, në linjë me outputet e të mësuarit sa i përket kompetencave kyqe dhe shkathtësive profesionale sikur të kërkuara nga ana e tregut të punës,
- **Vendosja e një metodologjie koordinuese** bazuar në një strukture konsorciumi, duke siguruar që Mobiliteti të arrij të jetë një aktivitet i zakonshëm e jo si një përjashtim, sikur theksuar nga ana e dokumenteve strategjike të Bashkimit Europian.

Kjo thirrje përmes këtij roundi tash ofron 12 grante mobiliteti për implementimin e internship-it në vendet europiane, organizuar në një periudhë që shkon përafërsisht prej 20/01/2023 deri 15/03/2023, me përjashtim të ndryshimeve tjera që mund të kërkojnë për arsye organizative.

Duke ju falenderuar mundësisë së ofruar nga ana e projektit tonë, numri i granteve të mobilitetit mund të rritet. Me këtë rast, kriteret përzgjedhëse do të bazohen sipas atyre të listuara në Nenit 5

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve:
15/12/2022

ora 12.00

Neni.1 –KRITERET FORMALE TË PËRSHTATSHMËRISË

Për të përmbushur kriteret e përshtatshmërisë (eligible), studentët duhet të jenë pjesë e shkollave/ofruesve të shkollimit profesional (VET providers/schools) dhe ndjekje në vite specifike të shkollimit/studimit sikur listuar në Nenin 14.

Individët mund të aplikojnë nëse ata përmbushin kërkesat e mëposhtme në kohën e para-aplikimit në këtë thirrje:

- Të jetë një student ndjekës i shkollave/ofruesve të shkollimit profesional (VET providers/schools) në mesin e atyre të listuar në Nenin 14.
- Të jetë ndjekës i kurseve trainuese specifike dhe vite specifike të studimeve sikur listuar në nenin 12 për secilin round;
- Të jete të paktën 16 vjeqar;
- Të jetë nënshitetas resident i Republikës së Kosovës, ose qytetar i vendeve anëtare të BE, legalisht banues në Republikën e Kosovës, qytetarë të vendeve jashte BE, legalisht banues në Republikën e Kosovës;
- Të zotërojnë një nivel të mjaftueshëm të gjuhës së vendit nikoqir ose Anglishten e nivelit komunikues. Është e domosdoshme ofrimi i çfardo Certificate si dëshmi e shkathtësive të gjuhës, sepse këto do të vlerësohen gjatë procesit të aplikimit sikur të cekura më lart në procedurat aplikuese;
- Në përputhje me rregullat e vendosura në vendin që do të udhëtojnë, vetëm studentët e vaksinuar kundër Covid 19 me një nga vaksinat Pfizer, AstraZeneca, Moderna dhe Johnson & Johnson, mund të aplikojnë për këtë thirrje publike për praktika.
- Të mos ketë qenë përfitues i skemave të Mobilitetit, më herët përmes projektit të njëjtë European;
- Të posedoj dokumente valide Identifikuese (passport)

Neni.2 –PROCESI I APLIKIMIT DHE AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM

Aplikacionet duhet të dorëzohen **ONLINE** duke plotësuar një google form në [linkun](#) në vazhdim. **Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 15/12/2022 at 12.00**

Aplikacionet e pranuar pas afatit të kërkuar (deadline) nuk do të pranohen, pamvarësisht nga funksionimi normal i website-it. Prandaj, ju rekomandojmë të mos prisni deri në momentin e fundit për dorëzim të aplikimeve tuaja, duke iu shmangur ndonjë problemi që mund të ketë të bëjë me ngarkesën e sistemit.

Informata për kompletimin e Formës online të Aplikimit:

A: Numri Thirrjes: **INTERVET_Kosovë 3/2022_ST**

B: Roundi i Projektit: **Round 5**

C: Dokumentet e bashkangjitura nuk mund të jenë më të mëdha se 10MB secili,

D: Video e bashkangjitur nuk mund të jetë më e madhe se 100MB,

E: Dokumentet e bashkangjitura dhe videoja duhet të emërtohen secila sikurse specifikuar në formën online,

F: Meqënëse ju nuk mund t'a ruani (save) formën gjersa ju e plotësoni atë, rekomandohet që ju të përgatisni një draft si word dokument dhe pastaj e kopjoni dhe bartni (copy and paste) përgjigjet në formën online,

G: Pas dorëzimit, aplikimi nuk mund të ndryshohet ose ri-dërgohet edhe njëherë,

H: Ju do të pranoni një email në llogarinë tuaj në Gmail (*vetem përmes gmail mund të aplikohet*) duke ju konfirmuar që aplikimi juaj është pranuar (ju lutem, nëse nuk pranoni konfrimim, kontrolli në folderin e juaj *spam*). Në rast të dështimit të njoftimit, ju lutem kontaktoni në prishtinarea@yahoo.com për të verifikuar që aplikacioni juaj është dorëzuar në mënyrë të rregullt.

Neni. 3 – DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

Dokumentacioni i kërkuar për të marrë pjesë në projekt është sikur në vijim:

KENI VËMENDJEN: Për t'a plotësuar Formën e Aplikimit, nevojitet një Llogari në Gmail. Nëse ju veç keni llogari në Gmail, ju lutem, log-in [ketu](#), nëse nuk keni, ju lutem krijoni një të tillë [këtu](#).

Dokumentet e kërkuara për aplikim, janë sikur më poshtë:

1. **Forma e Aplikacionit:** të plotësohet online, linku është në dispozicion në website-in (www.intervetwb.net) në faqen e dedikuar të

(<https://intervetwb.net/calls-kosovo/>). Shumica e pyetjeve në formën e aplikacionit janë obligative (mandatory). Të gjitha duhet të plotësohen në Anglisht dhe në një mënyrë të qartë e komprehensive. Pas të këni kompletuar Formën e Aplikacionit, ju do të pranoni një njoftim konfirmues ne emailin tuaj.

- 2. Europass Curriculum Vitae** (<https://europass.cedefop.europa.eu/editors/it/cv/compose>) në **Anglisht:** me emër të saktë të kursit që kandidati po e ndjek, dhe shkaktësitë e tij/saj, përvoja dhe foto. File duhet të emërtohet me titull sikur në vazhdim: “Mbiemri_Emri_CV_EN” (in *ËORD or PDF, max 10MB*)
- 3. Kopje e një ID dokumenti valid** (passporte) titulluar si në vazhdim:¹“Mbiemri_Emri_ID” (in *PDF, max 10MB*)
- 4. Motivational video** max kohëzgjatje prej 60 secondash. Videoja duhet të jetë tërësisht individuale. Secili student duhet t’ju përgjigjet pyetjeve: “*pse dëshironi të merrni pjesë dhe cilat detyra do të donit t’i ndërmerri te kompania nikoqire në vendet e BE*”. Ky file duhet të emërtohet sikur në vijim: “Mbiemri_Emri_Video” (in *MP4, MOV or AVI, max 100MB*)

Nëse videoja juaj ka format tjetër, ju lutem e konvertoni atë në një program sikur [Online Convert](#)

Neni.4 – INFORMATA SHITESË DHE KRITERET E JO-PËRSHTATSHMËRISË

UNISER rezervon të drejtën të kërkoj informata shtesë, sqarime shtesë dhe ose dokumente tjerë mbështetëse kandidatit/es ose VET Shkolles së tij/saj.

Kërkesa për informata shtesë procedohet vetëm përmes emailit të përdorur gjatë aplikimit. Nëse kandidati nuk kthen përgjigje mbrenda 2 ditë pune pas kërkesës për informata shtesë, aplikimi i tij/saj refuzohet automatikisht.

¹ Tw gjitha tw dhwnat personale tw ofruara nga kandidatwt in aplikim do tw pwrdoen eksklusivisht pwr qwillimet e menagjimit tw procedurave selektuese

UNISER dhe *Prishtina REA* nuk do të jenë përgjegjës për çfardo vonese ose dështimi të pranimit të aplikacionit për shkak të gabimeve në procedurat e aplikimit online ose arsye tjera që nuk varen nga konsorcium ynë, dhe/ose partnerët e BE.

Aplikimet të cilat **nuk i plotësojnë kërkesat e mëposhtme do të refuzohen automatikisht:**

- Mungojnë dokumentet e kërkuara ose pjesë të tyre;
- Mungon dokumentacioni digjital ose pjesë të tyre mbrenda afatit të specifikuar;
- Mungojnë një ose më shumë e kërkesave formale të përshtatshmërisë (eligibility) për të marrë pjesë në projekt (Neni.1);
- Mungon Pëlqimi për procesim të të dhënave personale në formën online.

Uniser dhe *Prishtina REA* rezervojnë të drejtën që të ndërmarrin verifikime të nevojshme, kontrole, përfshirë vizitë në terren, sa i përket deklarimeve dhe dokumentacioneve të dorëzuara. Ju lutem, keni parasysh që dokumentet falso do të qojnë në veprime juridike nëse është e nevojshme, dhe do të raportohen sipas ligjeve në fuqi.

Neni. 5 – TERMAT DHE KRITERET E SELEKTIMIT

Selektimi i kandidatëve do të zhvillohet sikur në vijim: studentët që përmbushin kriteret formale (neni .1) duhet të dorëzojnë aplikacionet e tyre online përmes Application Form në dispozicion në website <http://www.intervetwb.net> bashkë me të gjitha dokumentet e kërkuara (neni. 3) mbrenda afatit të përcaktuar në thirrje (neni.2).

Vlerësimi i studentëve do të ndahet në dy pjesë dhe do të zhvillohet sikur në vijim:

1. FAZA 1 – Para-Selektimi Automatik

Secili kandidatë do të marr një poentim automatik (nga 0 deri në 50 poena) e që mvaret nga përgjigjet e dhëna në Application Form.

Për të garantuar një akses të drejtë dhe të barabartë për të gjitha institucionet arsimore partnere të konsorciumit dhe pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve në projekt, 26 aplikantë do të pranohen dhe do të ndahen si më poshtë:

- Jo më shumë së 2 kandidatë për secilen shkollë,
- Projekti mbështet, avancon dhe zbaton kriteret e përzgjedhjes që nxisin barazinë gjinore. Pesëdhjetë për qind e granteve të disponueshme janë caktuar për kandidatët meshkuj dhe femra përkatësisht, kur është e përshtatshme;
- Aplikantët me poentimin më të lartë të secilës shkollë, në mesin e shkollave të listuara në nenin 14;

Nëse ndodh të jenë 3 kandidatë nga e njëjta shkollë në mesin e 26 të parëve, i treti nuk do të pranohet në FAZEN 2.

Në rastin kur kemi të bëjme me kriterin e poentimit maximal të 2 kandidatëve për shkollë, një numër prej më pak se 26 do të merret, kandidatët e mëtejshëm nga të gjithë pjesëmarrësit në thirrje do të pranohen në fazën 2 sipas kriterit të pikës më të lartë dhe barazisë gjinore.

Në rastin kur kemi poentim të barabartë, prioritet do t'u jipet studentëve të cilët nuk kanë marrë pjesë më herët në përvoja të tilla. Nësë, prapë, një gjë e tillë qon në poentim të barabartë, prioritet do t'i jipet aplikantit më të vjetër.

2. FAZA 2: Selektimi

Në këtë fazë, Format e Aplikimit të studentëve dhe videot motivuese do të vlerësohen, secili aplikim do të marrë poena prej 0 deri në 50 poena, të ndarë sikur më poshtë:

Nga 0 deri në 25 poena, në varësi të aftësisë komunikuese dmth niveli i gjuhës Angleze, qartësia e shprehjes, përdorimi i videos motivuese, përputhshmëria me instrukcionet, shkathtësitë në të folur dhe shkruar dhe vokabulari,

Nga 0 deri në 25 poena bazuar në motivimin e studentit (qartësia dhe relevanca e motivimit të shprehur, pritjet në linjë me profilin vetanak të tij/saj dhe me projektin tonë),

Në vlerësimin e aplikacioneve të studentëve, poentimi bazohet në diskrecionin e vlerësuesve sa i përket vlerësimit të shkathtësive të gjuhës dhe motivimi i prezentuar përmes videos dhe Formës së Aplikacionit,

N.B.: Në qoftë se dy e më shumë studentë nga e njëjta shkollë sjellim Deklarime shumë të ngjashme sa i përket termave të formës dhe përmabajtjes në lidhje me videon motivuese dhe Formave të Aplikimit, një Dokument Shtesë do të kërkohet. Dokumenti Shtesë duhet të dërgohet mbrenda afatit të kërkuar sikur specifikuar në nenin.4, përndryshe *poentimi që korrespondon me motivimin ose komunikimin do të jetë zero.*

Secili aplikant mund të përfundoj si në vijim:

1. I PËRSHTATSHËM

Të gjithë aplikantët me poentim më të lartë se ose të barabartë me 50 nga 100 në total do të konsiderohen si të përshtatshëm,

2. FITUES

Aplikantët me pikët më të larta duke respektuar barazinë gjinore do të dalin fitues (duke përjashtuar aplikantët e vlerësuar si të PA PËRSHTATSHËM)

Në rastin e poentimit të barabartë, prioritet ju jipet studentëve të cilët nuk kanë marrë pjesë më herët në eksperiencë të ngjashme. Nëse kjo prapë qon në poentim të barabartë, prioritet do t'ju jipet aplikantëve më të vjetër.

3. TË PËRSHTATSHËM, JO FITUES

Secili aplikantë më poentim më të lartë ose të barabartë me 50 nga 100 në total do të konsiderohet *si i përshtatshëm*, jo fitues (rezervë) dmth ai/ajo nuk do të fitoj grantin, sikurse presentuar në nenin 5.2 të kësaj thirrje për pjesëmarrës. Nëse ndonjëri nga kandidatët fitues hjek dorë, ai/ajo do të zëvendësohet duke qenë fitues i grantit (shiko nenin .6).

4. JO I PËRSHTATSHËM

Secili aplikant i cili merr poentim më të ulët se 50 nga totali prej 100 në Fazën 2 do të konsiderohet jo i përshtatshëm.

5. NUK PRANOHEM NË FAZËN 2

Çdo njëri aplikant tjetër i cili nuk është vlerësuar në fazën e dytë të selektimit, sikur vendosur në nenin 4 të kësaj thirrje për pjesëmarrës.

Neni. 6 – PUBLIKIMI I REZULTATEVE DHE DORËHEQJET

Rezultatet e selektimit do të publikohen në (<https://intervetwb.net/calls-kosovo/>). Rezultatet do të përfshijnë listën e aplikantëve të përshtatshëm (fituesit dhe ata rezervë), listën aplikantëve të cilët dolën si jo të përshtatshëm dhe përfundimisht lista e atyre që nuk pranohen në fazën 2.

Fituesit kanë 7 ditë punë në dispozicion për të konfirmuar/pranuar internshipin në vendet e ofruara të BE.

Në rast se ndonjëri nga fituesit **hjekë dorë** dhe/ose nuk e pranon grantin, lista rezervë do të përdoret për të selektuar aplikantën e radhës; sa i përket listës rezervë, aplikanti me poentimin më të lartë nga shkolla e njëjtë do të përzgjedhet (duke përjashtuar aplikantët që dolën si JO TË PËRSHTATSHËM) . Vëmendje do t'i kushtohet respektimit të objektivave të projektit për barazinë gjinore.

Në rast se shkolla nuk ka një list rezerve, granti do të kalohet të aplikanti me poentimin më të lartë (i përshtatshëm, jo-fitues) nga shkollat tjera. Vëmendje do t'i kushtohet respektimit të objektivave të projektit për barazinë gjinore.

Nëse ndodh që të gjithë aplikantët e pranuar në fazën 2, dalin të jenë osë fitues ose jo të përshtatshëm dhe nëse ende ka grantë në dispozicion, Uniser dhe Prishtina REA rezervojnë të drejtën e vlerësimit të aplikantit-ëve me poentimin më të lartë i cili nuk ka qenë i pranuar në fazën e 2 të selektimit. Vëmendje do t'i kushtohet respektimit të objektivave të projektit për barazinë gjinore.

VËREJTJE: Të gjitha komunikimet që kanë të bëjnë me selektimin do të administrohen përmes, koordinatori nuk mban përgjegjësi në rast se kandidatët nuk përcjellin rezultatet ose nuk përgjigjen kur janë të selektuar.

Neni. 7 – KOSTOT QË MBULOHEN NGA ANA E PROJEKTIT

Programi European i cili financon këtë projekt mbulon kostot si në vijim:

- Akomodimin dhe qëndrimin (para për jetesë) gjatë 1 muaj internshipit jashtë vendi;
- Biletat kthyesë në vendin ku zhvillohet internshipi;
- Përgatitjet ndërkulturore dhe pedagogjike para nisjes jashtë vendi;
- Kurset e Gjuhës;
- Sigurimi, që mbulon sigurimin shëndetësor, përgjegjësia e palës së tretë dhe lëndimet në vend punë për kohën e Internshipit 1 muaj;
- Organizimin e gjetjes dhe vendosjes në kompani;
- Tutorimin për kohëzgjatjen e projektit dhe përkrahje në të gjitha procedurat administrative dhe arranzhimet logjistike gjatë qëndrimit në vendin e mbajtjes së internshipit,
- Të paktën një vizitë kulturore,
- Biletat e transportit publik për të shkuar në punë dhe kthimi nga puna

Kostot e projektit do të grantohen sipas limiteve dhe kushteve të parapara në projekt EAC-2019-0571. Menagjeri i projektit ka mundësinë e plotë për përcaktimin e shumave të grantuara për aktivitetin e projektit me limitet dhe kushtet e përmendura më lart.

Uniser është plotësisht përgjegjës për organizimin dhe monitorimin e të gjitha fazave të Projektit. Do të koordinoj partneritete lokale dhe transnacionale me qëllim të arritjes së objektivave të projektit.

Uniser bashkë me Prishtina REA poashtu janë të ngarkuar edhe me menagjimin financiar, që përfshinë pagesat e organizatave jashtë vendi për akomodim dhe pagesat direkte të biletave për fluturim për internship-at.

Projekti nuk parashikon pagesa direkte te internsi/pjesëmarrësi, koordinatori është përgjegjës për të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me implementimin e aktiviteteve.

Neni. 8 – TRAINIMI PARA-NISJES

Kandidati i selektuar duhet të marrë pjesë në trainimin para-nisjes që do të organizohet pas selektimit dhe para fillimit të mobilitetit jashtë vendi. Përgatitjet konsistojnë në përgatitjet personale, kulturore dhe të punës.

Shtesë kësaj një kursë Gjuhe do të ofrohet para Mobilitetit nga ana e Organizatës Dërguese. Kursi i gjuhës është obligativë/mandator dhe të gjithë studentët duhet të ndjekun të paktën 80% e orëve të organizuara.

Pjesëmarrje aktive në aktivitetet përgatitore është obligativ

Neni. 9 – AKTIVIZIMI I INTERNSHIP-IT

Internshipi jashtë vendi do të ndodh përafërsisht në mes të 01/6/2022 dhe 15/07/2022. Kandidatët e selektuar do të jenë flexibël dhe do të duhet të pajtohen sikur theksuar më lartë për një kohëzgjatje sikur me periudhën e përcaktuar të internshipit jashtë vendi nëse nuk ka pajtushmëri në këtë aspekt, edhe mund të rezultoj në humbjen e mundësisë për përfitim të internshipit.

Aktivizimi i internship-it mund të jëtë subjekt i kufizimeve që mund të ngriten për çfardo qoftë ndryshimesh në ligjet përkatëse që mund të ndodhin që nga publikimi i kësaj thirrjeje.

Internsat/praktikantët do të jenë në vazhdimësi të monitoruar nga ana e stafit të projektit, me qëllim të detektimit të çfardo qoftë problemi të raportuar nga ana e kompanisë ose pjesëmarrësit.

Kërkohet një bashkëpunim i plotë i pjesëmarrësve me stafin e projektit, që kjo përfshinë përgjigje të shpejta kur kërkohen informata ose për ndonjë informatë tjetër ose qështje dokumentacioni që ka të bëjë me implementimin e aktiviteteve.

Neni. 10 PLANI KOHOR I PROJEKTIT

AKTIVITETET	DATA
Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve (neni. 2)	15/12/2022 H 12.00
Selektimi i Pjesëmarrësve (Neni 5)	20/12/2022
Trainimi përgatitorë (Neni. 7)	10 ditë para nisjes
Internshipi jashtë vendi	20/01/2023 - 15/03/2023

Neni. 11 – VENDI I DESTINACIONIT

Tabela e mëposhtme prezenton kualifikimet e targetuara dhe destinacionet asociuese me to për internship jashtë vendi. Koordinatorin rezervon të drejtën për të ndryshuar destinacionin e vendit për internship bazuar në nevojat e tij.

KUALIFIKIMET	VENDI I DESTINACIONIT
	<ul style="list-style-type: none"> ● Lyon, SEPR

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none">● Përpunimi i metaleve prej druri● Turizmi● Gastronomi | |
|--|--|

Kompanitë nikoqire të pjesëmarrësve/internsave për pranim të tyre do të identifikohen nga ana e koordinatorit në bashkëpunim me partnerin e jashtëm, nga vendet e BE bazuar në informatat që përmban Forma e Aplikacionit (shih Nenin 3) .

Internshipi i propozuar do të marrë parasysh poashtu edhe: nivelin e njohje së gjuhës angleze ose gjuhës së vendit të destinacionit; aspirimet profesionale të kandidatit të vlerësuar; kompetencat profesionale dhe transversale, me qëllim të gjetjes së dyanshmërisë reciproke më kompatible me kompanitë në dispozicion.

Neni. 12 –EVALUIMI FINAL

Në fund të mobilitetit, kandidatët do të marrin pjesë në një moment tjetër reflektimi të diskutimeve kolektive. Ky moment do të shfrytëzohet për të vlerësuar projektin nga aspekti organizacional dhe arsimor, këtu, ata do të luten edhe për të plotësuar një Pyetësor Vlerësimi Online. Takimi i vlerësimit është pjesë e projektit dhe, prandaj, pjesëmarrja është e detyrueshëm.

Neni. 13 - PËRGJEGJËSIA

Promoteri nuk do të jetë në asnjë rrethanë përgjegjës për çfardo përgjegjësie kontraktuale ose jo-kontraktuale ose përgjegjësie tjetër, në asnjë rast, që derivon nga performanca ose dështimi të performoj aktivitetet e ndërlidhura me këtë thirrje.

Neni. 14 PJESËMARRËSIT NGA OFRUESIT E ARSIMIT PROFESIONAL (VET PROVIDERS)

Studentët që ndjekun rregullisht këto shkolla të aftësimit profesional dhe që marin pjesë në një kursë për kualifikime mund të aplikojnë në këtë thirrje poashtu. [Këtu](#) e listës së pjesëmarrësve nga ofruesit e arsimit profesional (VET providers)

Neni. 15 INFORMATAT

Për çfardo sqarimi, ju mund të kontaktoni:

giulia@uniser.net

prishtinarea@yahoo.com